



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.11/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti kryesues, Violeta Husaj Rugova dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e paraqitura nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), të cilën me autorizim e përfaqëson Donat Lushaku, Albaton Bejta dhe Elsa Halili nga Prishtina, dhe Organizata Joqeveritare “Instituti i Kosovës për Drejtësi ( IKD)” me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson Ehat Miftaraj Drejtor Ekzekutiv, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 07.06.2026, në seancën e panelit të mbajtur më datë 03.06.2026, merr këtë,

V E N D I M

I. Pranohen të bazuara ankesat e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ZP.Anr.11/2026 e datës 01.06.2026, dhe ankesa e Organizatës Joqeveritare “Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD)” ZP.Anr.12/2026, e datës 01.06.2026, ashtu që subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të pjesëmarrjes së fëmijëve në fushatë zgjedhore, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 5.100 (pesëmijë e njëqind) €.

II. Detyrohet Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), që gjobën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 01.06.2026, PZAP-i, ka pranuar dy ankesa të identifikuara me numër ZP.Anr.11/2026 të parashtruar nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe ZP.Anr.12/2026, të parashtruar nga Organizata Joqeveritare “Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD)” me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë. Në ankesën ZP.Anr.11/2026, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës pretendon se me datë 30 Maj 2026, gjatë një tubimi zgjedhor të organizuar në Vushtri nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, kandidati për Kryeministër nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje Albin Kurti, ka ftuar në skenë një vajzë të mitur, rreth moshës 10 vjeçare, e cila ka recituar para pjesëmarrësve të tubimit. Me tutje në ankesë theksohet se vajza në tubimin në Vushtri gjatë fushatës zyrtare, reciton e veshur me rroba me llogon e subjektit në fjalë. Sipas parashtruesit të ankesës, pjesëmarrja aktive e fëmijës në skenë, para publikut dhe në kuadër të një aktivitetit të organizuar zgjedhor, përbën angazhim të një personi nën moshën 15 vjeçare në

fushatë zgjedhore, gjë që është e ndaluar nga rregullat zgjedhore në fuqi dhe se PZAP në rastet e mëhershme ka konstatuar se pjesëmarrja e fëmijëve në aktivitete dhe materiale të fushatës zgjedhore përbën shkelje të rregullave zgjedhore dhe ka shqiptuar gjopa ndaj subjekteve politike. Si provë në ankesë, parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur fotot dhe linkun nga tubimi zgjedhor i datës 30 maj 2026 në Vushtrri si dhe publikimet në rrjetet sociale dhe media lidhur me aktivitetin. Linku i videos së bashkangjitur: <https://ëëë.youtube.com/ëatch?v=DmGJJ2ACHco>, minuta 17:00. Parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP-i, që ta pranojë ankesën si të bazuar, të konstatojë së Lëvizja Vetëvendosje ka shkelur dispozitat e Rregullës Zgjedhore lidhur me përfshirjen e personave nën moshën 15 vjeçare në fushatë zgjedhore si dhe të shqiptoj sanksionet e parapara me legjislacion zgjedhor në fuqi dhe të urdhëroj ndërprerjen e praktikave të ngjashme gjatë pjesës së mbetur të fushatës zgjedhore.

Në ankesën ZP.Anr.12/2026, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), nga Organizata Joqeveritare “Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD)”, pretendon se ka pranuar informacione se gjatë një tubimit të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) të mbajtur në 31 Maj 2026 rreth orës 18:00, në Vushtrri, në skenë është përdorur një fëmijë nën moshën pesëmbëdhjetë vjeç. Tutje, parashtruesi i ankesës shton se ka shikuar video të tubimit, ku shihet kryetari i subjektit politik LVV, Albin Kurti, i cili i jep hapësirë në skenë një vajzë të mitur e cila reciton poezi me mesazhe politike, duke pasur të veshur një bluzë me logo të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje. Duke marrë parasysh këto, IKD thekson se subjekti politik ka shkelur Rregulloren Zgjedhore Nr.07/2024 për fushatën e zgjedhjeve, monitorimin e fushatës së zgjedhjeve dhe deklarimin financiar, konkretisht nenin 5 të kësaj Rregullore. IKD gjithashtu thekson se kjo sekuençë vazhdon të mbetet e përfshirë edhe në videon e transmetuar “live” nga ky tubim, e publikuar nga faqja zyrtare e këtij subjekti politik në rrjetin social “Facebook” si dhe kjo përmbajtje është shpërndarë gjerësisht nga faqe edhe përdorues të ndryshëm në rrjete sociale të ndryshme. Parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP-i, që ta pranojë ankesën si të bazuar, të konstatojë së Lëvizja Vetëvendosje ka shkelur dispozitat e Rregullës Zgjedhore lidhur me përfshirjen e personave nën moshën 15 vjeçare në fushatë zgjedhore si dhe të shqiptoj një gjobë, e cila do të ishte e përshtatshme për të parandaluar që në të ardhmen të përdoren fëmijët në fushata.

Në përgjigje në ankesat e paraqitura, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje sqaron se e mitura në fjalë nuk ka qenë pjesë e programit të organizuar të tubimit, nuk ka qenë e angazhuar nga subjekti i tyre dhe nuk ka pasur asnjë rol të planifikuar në aktivitetin zgjedhor. Sipas tyre, para fillimit të tubimit, e mitura i është afruar vetë kandidatit për kryeministër Albin Kurtit dhe ka kërkuar që t’i mundësohet të këndojë një këngë para të pranishmëve dhe se kjo është bërë në prani të prindit të saj, i cili ka qenë prezent në vendin e ngjarjes dhe nuk ka shprehur asnjë kundërshtim lidhur me veprimin e vajzës. Në përgjigje theksohet se në këto rrethana, nuk mund të flitet për “angazhim” të një personi nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç nga subjekti politik sepse iniciativa nuk ka ardhur nga organizatori por nga vetë e mitura. Më tej në përgjigje në ankesat e paraqitura po ashtu theksohet se në rastin konkret nuk ekziston asnjë provë që e mitura është ftuar, organizuar, koordinuar apo angazhuar nga Lëvizja Vetëvendosje. Sipas tyre ankesat nuk paraqesin asnjë provë që e vërteton ndonjë marrëveshje paraprake, organizim, udhëzim apo përfshirje të planifikuar të të miturës nga subjekti i tyre dhe se behët fjalë për një veprim spontan të një pjesëmarrëseje në tubim e i cili nuk mund të konsiderohet si “angazhim” që do të binte ndesh me rregullat zgjedhore. Tutje, LVV shton se ankuesit nuk pretendojnë dhe nuk dëshmojnë se prindi i të miturës ka kundërshtuar pjesëmarrjen e saj, ndërsa sipas tyre prindi ka qenë në tubim dhe se propozojnë edhe dëgjimin e dëshmitarëve relevantë, përfshirë prindin e të miturës.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat ZP.Anr.11/2026 dhe ZP.Anr.12/2026, të paraqitura me datë 01.06.2026, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët ZP.Anr.11/2026, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës ( LDK) dhe Organizata Joqeveritare “Instituti i Kosovës për Drejtësi ( IKD)”, kundër subjektit të njëjtë politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi pretendimet ankimore nga ankesa si dhe përgjigjen në ankesë, vëren se ankesat janë të bazuara.

Paneli shqyrtimit dhe vlerësimit të ankesës vëren se nga fotografitë dhe linku i ofruara si provë nga parashtruesit e ankesave, të cilat gjenden në shkresat e lëndëve, është konstatuar se në tubimin e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje më datë 31.05.2026, rreth orës 18.00, ka marrë pjesë edhe një fëmijë i mitur e veshur me rroba me logon e subjektit politik LVV, si dhe ka recituar para pjesëmarrësve në tubim, veprim ky që bie në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenin 5, paragrafi 3 të Rregullores Zgjedhore nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, me të cilën është përcaktuar se *“Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të angazhojë persona nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatë zgjedhore.”*

Paneli vlerëson se qëllimi i kësaj dispozite është mbrojtja e të miturve nga përfshirja në aktivitete të fushatës zgjedhore nga subjektet politike, dhe se në asnjë rrethanë nuk mund të marrin pjesë në aktivitete zgjedhore.

Paneli, me rastin e vendosjes i shqyrtoi edhe pretendimet në përgjigje në ankesë të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), se *“... nuk mund të flitet për angazhim të një personi nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeçare nga subjekti politik, sepse iniciativa nuk ka ardhur nga organizatori por nga vetë e mitura,”* Por të njëjtin pretendim e vlerësoi si të pabazuar, për faktin se në momentin kur organizatori i aktivitetit i ka mundësuar të miturës hyrjen në sallë, pastaj paraqitjen në skenë para publikut në kuadër të tubimit zgjedhor, pjesëmarrja e saj konsiderohet përfshirje aktive në fushatë zgjedhore. Sepse për zbatimin e kësaj norme nuk është vendimtare nëse iniciativa për paraqitjen e të miturës ka ardhur nga organizatori apo nga vetë e mitura, por vet fakti se subjekti politik ka lejuar dhe mundësuar pjesëmarrjen e saj aktive, apo edhe pasive në një aktivitet zyrtar zgjedhor.

Lidhur me pretendimin nga përgjigja në ankesë se *“Në rastin konkret nuk ekziston asnjë provë që e mitura është ftuar, organizuar, koordinuar apo angazhuar nga Lëvizja Vetëvendosje!...”* Këto pretendime paneli i vlerëson si të pabazuar, për faktin se nuk është më rëndësi në këtë rast se a ka pasur ftesë, organizim apo koordinim për të marrë pjesë e mitura në aktivitete politik, por me rëndësi është fakti se organizatori i këtij aktiviteti e ka lejuar që të marrë pjesë në këtë aktivitet politik, veprim ky i cili bije në kundërshtim me Rregulloren e sipërcituar.

Lidhur me pretendimin nga përgjigja në ankesë se *“Po ashtu se ankuesi nuk pretendon dhe nuk dëshmon se prindi ka kundërshtuar pjesëmarrjen e saj, ndërsa faktikisht ka qenë prezent në tubim. Ne, anën tjetër , e propozojmë dëgjimin e dëshmitarëve relevant, përfshirë dhe prindin e të miturës.”* Paneli vlerëson se është i parëndësishëm fakti se prindi i saj nuk e ka kundërshtuar pjesëmarrjen e saj në tubim, por rëndësishëm është fakti se e mitura në asnjë rrethanë nuk ka mundur të gjendet në atë aktivitet politik, e aq më shumë që të ftohet të recitoj siç edhe ka ndodhur ngase ky veprim si u tha më lartë bije në kundërshtim me rregullat

zgjedhore. Ndërsa lidhur me propozimin për dëgjimin e dëshmitareve të njëjtin propozim paneli e vlerëson si të pabazuar, për faktin se deklaratat e tyre nuk do të vërtetonin një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar më lartë.

Në këtë kuptim, për Panelin këto veprime janë në kundërshtim me dispozitën e nenit 5, paragrafi 3 të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar.

Paneli me rastin e vendosjes së lartësisë së dënimit më gjobë si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: se përfshirja e fëmijëve në fushata zgjedhore përbenë shkelje të drejtave të tyre, dhe se nuk është në interesin më të mirë të tyre që subjektet politike ti angazhojnë në fushata zgjedhore, po ashtu paneli ka vlerësuar natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, dhe se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, po ashtu faktin se i njëjti subjekt edhe në zgjedhjet e kaluara ka kryer të njëjtat veprime me ç'rast edhe i janë shqiptuar dënime me gjobë.

Mbi këtë bazë, e duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e subjekteve ankuese janë të bazuara, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa nga parashtruesit e ankesave paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, të rregullës zgjedhore.


Nga arsyet e theksuara më lart, e në kuptim nenit 118 paragrafi 1, dhe nenit 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.Anr.11/2026, datë 03.06.2026



Këshillë Juridike: kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda 48 (dyzet e tetë) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA SUPREME**

AA.nr.24/2026

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi, kryetar, Delushe Halimi dhe Lumni Sallauka anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik: Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.11/2026 të datës 03.06.2026, në seancën e mbajtur më datë 09.06.2026, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet e pathemeltë ankesa e parashtruar nga subjekti politik: Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.11/2026, të datës 03.06.2026.

**A r s y e t i m**

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.11/2026, të datës 03.06.2026, është vendosur: I.Pranohen si të bazuara ankesat e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ZP.Anr.11/2026 e datës 01.06.2026, dhe ankesa e Organizatës Joqeveritare “Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD)” ZP.Anr.12/2026 e datës 01.06.2026, ashtu që subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të pjesëmarrjes së fëmijëve në fushatë zgjedhore, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 5.100 (pesëmijë e njëqind) Euro. II.Detyrohet Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) që gjobën e shqiptuar si në pikën I- të dispozitivit të këtij vendimi të paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.



PZAP, në arsyetim të vendimit të lartcekur ndër të tjera ka theksuar se: në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores numër 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit numër 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës ka bashkuar ankesat ZP.Anr.11/2026 dhe ZP.Anr.12/2026, të paraqitura me datë 01.06.2026, dhe janë trajtuar me një vendim. Tutje, Paneli pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ankesës vëren se nga fotografitë dhe linku i ofruar si provë nga parashtruesit e ankesave të cilën gjenden në shkresat e lëndës, është konstatuar se në tubimin e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje me datë 31.05.2026 rreth orës 18:00 ka marr pjesë edhe një fëmijë i mitur e veshur me rroba me logon e subjektit politik LVV, si dhe ka recituar para pjesëmarrësve në tubim, veprim ky që bie në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 5 paragrafi 3 të Rregullores Zgjedhore numër 07/2024 për Fushatën Zgjedhore, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, me të cilën është përcaktuar se “Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të angazhojë persona nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatë zgjedhore.” Ky panel ka vlerësuar se qëllimi i kësaj dispozite është mbrojtja e të miturve nga përfshirja në aktivitete të fushatës zgjedhore nga subjektet politike, dhe se në asnjë rrethanë nuk mund të marrin pjesë në aktivitete zgjedhore.

Kundër këtij vendimi, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak se: vendimi është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat përkatëse dhe vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe shkelje të së drejtës materiale, duke propozuar që Gjykata Supreme e Kosovës që të: Aprovojë ankesën e parashtruar pranë kësaj gjykate, të anulojë Vendimin e PZAP-së ZP.Anr.11/2026 si të pabazuar dhe Zp.Anr.12/2026, dhe të konstatoj se PZAP ka zbatuar gabimisht nenin 5 paragrafi 3 të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024, të konstatoj se vendimi i PZAP-së është i mangët në arsyetim, për shkak se nuk e ka trajtuar në substancë pretendimin vendimtar, si dhe të vendos në mënyrë meritore duke refuzuar ankesën ndaj Lëvizjes Vetëvendosje si të pa bazuar, ose ta kthejë çështjen në rivendosje.

PZAP, ka paraqitur përgjigje në ankesën e paraqitur kundër vendimit të atakuar dhe ndër të tjera ka theksuar se: në tërësi e kundërshtojmë ankesën e paraqitur kundër vendimit ZP.Anr.11/2026 të datës 03.06.2026, tutje Paneli nga shqyrtimi dhe vlerësimi i ankesave ka vërejtur se nga fotografitë dhe linku i ofruar si provë nga parashtruesit e ankesave, të cilat janë



gjendur të bashkangjitura në shkresat e lëndës është konstatuar se në tubimin e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje me datë 31.05.2026 rreth orës 18:00, ka marrë pjesë edhe një fëmijë i mitur e veshur me rroba me logon e subjektit politik LVV, si dhe ka recituar para pjesëmarrësve në tubim veprim ky që bie ndesh me dispozitat e Rregullores Zgjedhore numër 07/2024 për Fushatën Zgjedhore, Monitorimin e Fushates së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

*Ankesa është e pathemeltë.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 01.06.2026, PZAP-i, ka pranuar dy ankesa me numër ZP.Anr.11/2026, nga subjekti politik: Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dhe ZP.Anr.12/2026 të ushtruar nga Organizata Joqeveritare “Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) me seli në Prishtinë, në lidhje me tubimin zgjedhor të organizuar në Vushtri nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, në të cilin tubim kandidati për Kryeministër Albin Kurti nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje ka ftuar në skenë një vajzë të mitur 10 vjeçare e cika ka recituar para pjesëmarrësve të tubimit, më tutje në ankesë theksohet se vajza e mitur në tubimin në Vushtri gjatë fushatës zyrtare reciton e veshur me rroba me logon e subjektit në fjalë. Dhe sipas parashtrueseve të ankesës pjesëmarrja aktive e fëmijës në skenë, para publikut dhe në kuadër të një aktiviteti të organizuar zgjedhor përbenë angazhim të një personi nën moshën 15 vjeçare në fushatë zgjedhore, gjë që është e ndaluar nga rregullat zgjedhore në fuqi.

Në përgjigje në ankesat e ushtruara në PZAP, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje thekson se e mitura në fjalë nuk ka qenë pjesë e programit të organizuar të tubimit, nuk ka qenë e angazhuar nga subjekti i tyre dhe nuk ka pasur rol të planifikuar në aktivitetin zgjedhor. Sipas tyre, para fillimit të tubimit e mitura i është afuar vetë kandidatit për Kryeministër Albin Kurti dhe ka kërkuar që t’i mundësohet të këndojë një këngë para të pranishmeve dhe se kjo është bërë në prani të prindërit të saj, i cili ka qenë prezent në vendin e ngjarjes dhe se nuk ka shprehur asnjë kundërshtim lidhur me veprimin e vajzës.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, me të cilin ka pranuar si të bazuara ankesat e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës



(LDK) ZP.Anr.11/2026 e datës 01.06.2026, dhe ankesa e Organizatës Joqeveritare “Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD)” ZP.Anr.12/2026 e datës 01.06.2026, ashtu që subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të pjesëmarrjes së fëmijëve në fushatë zgjedhore, i ka shqiptuar dënim me gjobë në lartësi prej 5.100 (pesëmijë e njëqind) Euro.

Gjykata Supreme e Kosovës, pretendimet e lartcekura i ka vlerësuar të pathemelta dhe të paqëndrueshme, kjo pasi me Rregulloren Zgjedhore numër 07/2024 për Fushatën Zgjedhore, Monitorimin e Fshehtë të Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar konkretisht neni 5 paragrafi 3 i të njëjtës përcakton se *“Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të angazhoj persona nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatën zgjedhore”* dhe nga shkresat e lëndës edhe kjo Gjykatë vëren se në tubimin e subjektit politik të Lëvizjes Vetëvendosje me datë 31.05.2026 ka marr pjesë një e mitur e moshës 10 vjeçare, pjesëmarrje kjo e cila është në kundërshtim me dispozitën e lartë cekur, dhe se nuk qëndron pretendimi ankimor i subjektit politik se PZAP në vend të analizoj nëse ka ekzistuar veprim aktiv i subjektit politik për të angazhuar të miturën në fushatë, i njëjti ka vlerësuar se nuk është me rëndësi nëse iniciativa ka ardhur nga organizatori apo nga vet e mitura dhe se nuk është me rëndësi nëse ka pasur ftesë takim apo koordinim paraprak, edhe kolegji i kësaj Gjykate e përkrah një qëndrim të tillë të PZAP ngase më me rëndësi është fakti se organizatori i këtij aktiviteti e ka lejuar pjesëmarrjen e një të miture në aktivitete të fushatës së tyre zgjedhore në kundërshtim me Rregulloren e lartcekur që ndalon përfshirjen e fëmijëve në fushatë, duke anashkaluar faktin se a ka pasur apo nuk ka pasur ftesë e mitura, vet pjesëmarrja e saj në fushatë përbën shkelje të dispozitave ligjore. Madje subjekti politik bie në kundërshtim me vetveten pasi që subjekti politik LVV ka qenë organizatori dhe vajza apo e mitura ka recituar në pjesën kryesore ku ka qëndruar folësi/kryetari i subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dhe ka mundur pa problem që me veprim aktiv ta ndalojë sepse ka qenë organizator sepse tubimi ka qenë i organizuar nga subjekti LVV. Folësit në tubim përcaktohen nga organizatori, dhe pa leje nga organizatori askush nga pjesa kryesore bina nuk mund ti drejtohet masës, por edhe në rrethanën e mos pjesëmarrjen aktive ( gjë që nuk ka ndodhur në rastin konkret sepse kemi pjesëmarrje të drejtpërdrejt aktive të fëmijëve pasi kjo shihet edhe në foto si provë të dorëzuar me ankesë në PZAP), prapë veprimi do të sanksionohet pasi që subjekti politik e ka pasur të ditur faktin se vet pjesëmarrja e të miturve/fëmijëve në fushatë apo aktivitetet zgjedhore ndëshkohet e krejt kjo me qëllim të mbrojtje së interesit të fëmijëve.



Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 4, 39 paragrafi 3 dhe nenin 119 paragrafi 1, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

AA.nr.24/2026 me datë 09.06.2026

Kryetar i kolegjit,

Faton Ademi



Republika e Kosovës  Republika Kosovo  
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON  
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar  
Ovlašćeni radnik  
